



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:096953

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06344981

KF.nr.650/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar –administrativ të paditësit “Agrounion”, Sh.P.K. me numër unik identifikues 810344573 dhe me seli në Fushë Kosovë, përfaqësuar nga Kushtrim Bytyqi ,Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit, jashtë seancës, me datë 24.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet se është tërhequr padia e paditësit “Agrounion” Sh.P.K. me seli në Fushë Kosovë, të cilin me autorizim e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, avokat nga Prishtina, e regjistruar nën shenjën KF.nr.650/22 e datës 16.05.2022, për mos pagesën e taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësi, ka ushtruar padi pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës –Divizoni Fiskal më datë 16.05.2022 kundër të paditurës Dogana e Kosovës, për anulimin e vendimit me nr. 01.3.2.2/4483 të datës 13.04.2021.

Gjykata, paditësit i ka dërguar vërejtjen gjyqësore me të cilën e ka obliguar që gjykatës ti paguaj taksën gjyqësore në vlerë prej 20 euro, në afatin prej 15 ditëve, në të kundërtën padia do të konsiderohet e tërhequr.

Nga fletë kthesa për dorëzim personal vërtetohet se paditësi vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore e ka pranuar më datë 03.09.2024, mirëpo paditësi as në afatin e caktuar me vërejte dhe as deri në ditën e nxjerrjes së këtij aktvendimi nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Duke pasur parasysh që paditësi në afatin prej 15 ditëve sipas vërejtjes së gjykatës, nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore edhe pse në vërejtjen e gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore, është paralajmëruar se në qoftë se në afatin e caktuar nga gjykata nuk e paguan taksën gjyqësore, konform Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të ndryshuar sipas UA nr.2/2017 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore e lidhur me nenin 253 të LPK-së, padia do të konsiderohet se është tërhequr.

Pasi që paditësi nuk ka paguar taksën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, gjykata duke marrë parasysh arsyet e dhëna me lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të ndryshuar sipas UA nr.2/2017 për Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti Fiskal

KF.nr.650/22, datë 24.10.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.